

## GSK-KPA-A-021-2016

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Nebojša Boričić, anëtarë, me bashkëpunëtor profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **Palës ankuese** :

**H. K. nga** Komuna e Obiliqit

**Kundër Palës përgjegjëse në ankesë:**

**R. P. Lazarevac-** Republika e Serbisë

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/258/2014 të datës 21 Tetor 2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA14870), pas këshillimit të mbajtur më 20 Maj 2019, mori këtë:

### **AKTGJYKIM**

**Ankesa e paraqitur nga H. K. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/258/2014 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA14870) të datës 21 Tetor 2014, hidhet poshtë si e papranueshme për shkak se pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën e shkallës së parë (Neni 10.2 i Ligjit nr.03/L-079).**

### **Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 11 December 2006, R. P. (më tej: pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur një kërkesë në AKP duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë e babait tje tij N. P., dhe ririposimin e ngastrës kadastrale ..., që ndodhet në vendin e quajtur “Breg Pistoljina”, zona kadastrale ..., Komuna e Kasrtriotit/Obilić, me sipërfaqe pre 0.95.30 h, (më tej: prona e kërkuar). Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se babi i tij është pronarë dhe se e kanë humbur posedimin mbi të më 18 Qershor 1999 si rezultat i rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në vitin 1998/1999 në Kosovë. Më vonë pala përgjegjëse ka deshmuar se pronën e kërkuar në procedure trashigimore e ka regjistruar ne emër të tij.
2. Për ta mbështetur kërkesën, pala përgjegjëse në ankesë dorëzoi në AKP:
  - Lista poseduese Nr. ... leshuar nga Zyra kadastrale e Prishtinës e dislokuar në Serbi me 6 Shtator 2004 ku evidentohet se i apti i palës përgjegjëse Novak është pronar i pronës së kërkuar.

- Kopje e planit e ngstrës ..., lëshuar nga Zyra kadastrale e Prishtinës e dislokuar në Serbi me 6 Shtator 2004 ku evidentohet se i ati i palës përgjegjëse N. është pronar i pronës së kërkuar.
  - Letërnjoftim i lëshuar nga autoriutete e Prishtinës me 2 Qershor 1997 në emër të palës përgjegjëse.
  - Aktvendim Trashigimor ).Br.230/10&328/10 mbi shqyrtimin e mëvonshem të trashigimisë së të ndjerit N. P.,me 24 Nëntor 2010 lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishinës-dega në Graçanicë ku shpallej trashigimtar i pronës së kërkuar pala përgjegjëse.
  - Certifikatë pronësie e datës 29 Dhjetor 2010 me të cilin dëshmohej se pala përgjegjëse e kishte azhuruar regjistrin kadastral dhe tani ishte pronar i ngastres ...
  - Kopje plani e datës 29 Dhjetor 2010 me të cilin deshmohej se pala përgjegjëse e kishte azhuruar regjistrin kadastral dhe tani ishte pronar i ngastres ...,
3. Më 25 Shtator 2007, AKP-ja e vendosi shenjën në pronën e kërkuar dhe u gjet se prona e kërkuar ishte tokë e papunur dhe nuk kishte shenja se e njehta është në posedim apo shfrytëzim nga ndokush.
  4. Askush nuk është paraqitur në përgjigje të kërkesës.
  5. Dokumentet e prezantuara nga pala përgjegjëse në ankesë janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së.
  6. Më 19 Dhjetor 2007, KKKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/5/2007 vendosi se pala përgjegjëse në ankesë kishte vërtetuar se ishte pronari i pronës së kërkuar dhe se kishte të drejtën e posedimit të pronës në fjalë.
  7. Më 19 Shkurt 2010 KKKPK-ja me rezolutën e vet KPCC/RES/15/2010 për shkak te gabimeve në njoftim dhe identifikim të pronës kishte shfuqizuar venimin e vet dhe çështjen e kishte kthyer në rivendosje.
  8. Me 30 Gusht 2010 AKP-ja e publikoi kërkesën ne gazetën Nr.7 dhe eshperndau tek lideri i fshatit, Komuna e Obiliqit, Gjykata komunale në Prishtinë zyra rajonale e AKP-së dhe Ombudspersoni, zyra e UNHCR-së zyra e UNMIK-ut në Graçanicë etj.
  9. Me 21 Tetor 2014 KKKK me vendimin e ket KPCC/D/A/258/2010 vendosi se pala përgjegjëse në ankesë kishte vërtetuar se ishte pronari i pronës së kërkuar dhe se kishte të drejtën e posedimit të pronës në fjalë.
  10. Vendimi iu dorëzua palës përgjegjëse ne ankesë më 15 Prill 2014. Me 23 Shkurt 2016 H. K., ka paraqitur ankese ne vendiin e KKKPKsë. Me 31 Mars 2016 i është derguar palës përgjegjëse një kopje e Ankesës dhe nuk ka evidence se e njeta është përgjigjur në afat prej

30 ditës gjejesisht me 15 Prill 2016. Në procedurën e shkallës së parë askush tjetër nuk kishte mar pjesë dhe nuk e kishte kundërshtuar kërkesën e palës për kthimin e pronës.

### **Pretendimet e palës ankuese:**

11. Pala ankuese pretendon se Vendimi i KKKPK-së bazohet në vërtetim të gabueshëm apo të mangët të gjendjes faktike.
12. Pala ankuese pretendon se toka ka qenë e familjës setyre sepse babai i tij e blere prej Radovan Perović dhe se per këtë ka deponuar dëshmitë e bashkëfshatarëve: Sh. J., F.C. , E. K. dhe A. K. te cilet deklarojne familja e H. K. e ka blerë pronën prej R. P. dhe ajo e punon tokën .

### **Arsyetimi ligjor *Pranueshmëria e ankesës***

13. Ankesa është e papranueshme sepse është paraqitur nga një person që nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë para KKKPK-së.
14. Në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr.03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës rreth Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.
15. Neni 10.1 i Ligjit nr.03/L-079 parasheh se pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive njofton dhe dërgon një kopje të kërkesës çdo personi përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës. Neni 10.2 i ligjit të njëjtë parasheh se “*Çdo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës dhe/ose ndonjë person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronën e kërkuar do të jetë palë ... , me kusht që ai person e informon Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij/saj që të marr pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive [...]*”.
16. Vetëm pala në procedurë në shkallën e parë ka të drejtë që të paraqet ankesë kundër Vendimit të KKKPK-së. Bazuar në praktikën e Gjykatës Supreme, përjashtimi i vetëm ndaj këtij rregulli paraqitet nëse personi i cili mund të kërkojë një të drejtë mbi pronën e kontestuar nuk ka pasur njohuri se kërkesa ishte paraqitur në AKP për shkak të njoftimit të gabueshëm dhe prandaj ai/ajo nuk është në gjendje ta paraqet njoftimin e pjesëmarrjes gjatë procedurës në shkallën e parë.
17. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 përcakton se: “brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga AKP-ja për vendimin e KKKPK-së për kërkesa, pala mund të paraqesë [...] ankesë ndaj vendimit të tillë”. Pala ankuese nuk e arsyetojnë se pse nuk kanë marrë pjesën në shkallë të parë në mënyrë që të mund të pranohen si palë në procedurë tani.

18. Në rastin në fjalë, Gjykata Supreme është e mendimit se pala ankuese ka qenë në dijeni për procedurën në lëndën KPA14870, ngase prona është vizitur në Shtator të vitit 2007 dhe është gjetur kullose e pa ndertesa. Sekretaria Me 30 Gusht 2010 AKP-ja e publikoi kërkesën në gazetën Nr.7 dhe e shperndau tek lideri i fshatit, Komuna e Obiliqit, Gjykata komunale në Prishtinë zyra rajonale e AKP-së dhe Ombudspersoni, zyra e UNHCR-së zyra e UNMIK-ut në Graçanicë etj. Prandaj konsiderohet se njoftimi ishte bërë në përputhje me Nenin 10.2 të Ligjit nr.03/L-079 dhe që nga vitit 2010 deri në ekzekutimin e vendimit lidhur me kthimin e posedimit pala ankuese nuk kishte shfaqur interes për pronën e kërkuar.
19. Gjykata vëren se pretendimet e palës ankuese nuk mund të merren në konsiderate për shkak se pala ankuese nuk e ka dëshmuar me asnjë provë deklarimin e tij e as që e ka vë në dyshim të drejtën ligjore të palës përgjegjëse.
20. Gjykata Supreme në bazë të fakteve të lartëcekura konstaton se pala ankuese i ka pasur të gjitha mundësitë që të jetë në dijeni për procedurën që po zhvillohej në shkallën e parë, duke pasur parasysh se njoftimi ishte kryer si duhet duke i vendosur shenjat përkatëse të prona e kërkuar.
21. Në ankesë nuk ka dhënë as një arsye se pse nuk ka marr pjesë në procedurë në shkallën e parë dhe nuk pretendon parregullësi në njoftim për kërkesën lidhur me pronën dhe përkunder faktit se në shkallën e parë nuk ka marr pjesë e as që e ka arsyetuar mospjesmarrjen me ankesë nuk është paraqitur asnjë provë me të cilën do të vihej në dyshim e drejta pronësore e palës përgjegjëse(dokumentat e tanishme deshmojne se me azhurimin e vitit 2010 prona evidentohet në emër të palës përgjegjëse). Megjithatë ankesa duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 12.1 dhe 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1, nën-paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Prandaj, Kolegji vendosi sikurse në dispozitiv.

#### **Këshillë ligjore:**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr.03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

### **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NE PRISHTINE**

**GSK-KPA-A-021/2016 me datën 20 Maj 2019**

**KRYETARI I KOLEGJIT**

**Beshir Islami**